



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira - Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

DPL.nr.25/2022

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevci dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën përmbarimore, P.nr.202/2022, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Burbuqe Spahija-Kerveshi dhe Përmbaruesi Privat, me datë 23.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-25/2022 i datës 19.08.2022, si i pa bazuar.

II. Përmbaruesi Privat si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbarimore , P.nr.202/2022.

A r s y e t i m

Me datën 16.08.2022 ,Divizioni Për Mbikqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira,ka parashtruar raportin e inspektimit, nr.11/2022,pas inspektimit të zyrës së përmbaruesit ,me pretendimin se përmbaruesi privat përkundër që debitori ka paraqitur prapësim në këtë rast në afatin e paraparë ligjor,përmbaruesi ka vepruar ashtuqë ka bllokuar llogaritë bankare, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Raportit i është bashkangjitur edhe vendimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës, PPP.nr.598/2022, i dt.22.07.2022 ,me të cilin është aprovuar ankesa e palës debitore për parregullsitë e përmbaruesit ,pasi janë bllokuar llogaritë pa e pritur vendimin për prapësimin,me të cilat veprime sipas vendimit

të gjykatës, përmbaruesi ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 47,par.5, nenit 116 par.1 dhe nenit 127 të LPP-së.

Bazuar në këto sipas raportit të inspektimit ,përmbaruesi ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 47,par.5, nenit 74 par.1 dhe nenit 127 par.1 të LPP-së.

I ka propozuar komisionit që të ndërmirren masa ndaj përmbaruesit privat në proporcion me shkeljet e bëra.

Me datën 19.05.2022, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka paraqitur në komision Raportin Përfundimtar ndaj përmbaruesit privat, lidhur me veprimet përmbarimore për këtë lëndë.

Përmbaruesi Privat, në deklaratën e tij ka theksuar se tek këto raste bazë për inicim është marrëveshja e pengut,e cila konkretizon se përmbarimi lejohet vetëm për atë peng dhe mbi atë bazë sipas dispozitave të nenit 167 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore,parashihet ekzekutimi gjyqësor i pengut.

Sa i përket vendimit të Gjykatës Themelor në PPP.nr.598/2022,dt.22.07.2022 ,me të cilin është aprovuar ankesa e palës debitore për parregullsitë e përmbaruesit privat ,pasi janë bllokuar llogaritë pa e pritur vendimin për prapësimin,ai vendim ka ardhur si pasojë e aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Më tutje përmbaruesi ka parashtruar se dispozita e nenit 47,par.4 të LPP-së,me Plotësim ndryshimin e Ligjit për Pocerurën Përmbarimore ,Ligji nr.05/L-118,konkretisht sipas dispozitës së nenit 7 të këtij ligji ,dispozita e nenit 47,par.4 të LPP-së, është e shfuqizuar,kështu që vendimi i gjykatës ka ardhur bazuar në një dispozitë të shfuqizuar,si dhe ai vendim nuk është i plotfuqishëm,pasi lënda gjindet me ankesë,meqë kreditori ka parashtruar ankesë.

Në seancën dëgjimore ,përmbaruesi privat poashtu ka deklaruar se mbetet ne tërësi pranë përgjigjes së dhënë dhe se i njejt i nuk ka diçka të shtoj, pasi si përmbarues kanë dilema se si t'a zbatojnë ligjin , përkatësisht se janë në dilema a duhet t'i zbatojnë dispozitat ligjore kësisoj apo jo.Kur përmbarimi iniciohet ne bazë të dokumentit përmbarues, marrëveshjes së pengut ,për këto lëndë dispozita përkatëse është neni 167 i Ligjit për Pronësinë dhe te Drejtat Tjera Sendore, mbi këtë bazë mendojnë dhe konsiderojnë se duhet të veprohet kështu, përveç nëse ndonjë institucion kompetent apo organ kompetent do t'u ofroi ndonjë sqarim ndryshe. Më tutje përmbaruesi ka shtuar se këtu përmbarimi lejohet vetëm ndaj objektit të përmbarimit sipas marrëveshjes së pengut.Kështu nëse si përmbarues , nuk veprojnë , i japin mundësinë debitorit që të njëjtin peng t'a tjetërsojnë apo t'i pamundësohet kreditorit realizimi i kërkesës së vet e kreditori do të mund të kërkoj sqarime dhe se pikërisht atëherë ,do të bënin shkelje si organ përmbarues,në interpretim ndryshe dhe mos veprim kësisoj.

E njoftoi komisionin se nga Gjykata Themelore në kanë pranuar Aktvendimin ,PPP nr. 598/2022, ime dt.05.09.2022,me të cilin është refuzuar prapësimi i debitorit; se si përmbarues me qëllim sqarimi të kësaj dispozite dhe interpretimi të saktë,duke dashur që mos të bëjë ndonjë shkelje,për shkak të interpretimeve të ndryshme do të kërkoj në të ardhmen nga organet e Odës së Përmbaruesve Privat ,që oda t'u drejtohet institucioneve kompetente për mendim juridik për interpretim të dispozitës së nenit 167 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore,kjo me të vetmin qëllim që për shkak të mos sqarimit të duhur të kësaj dispozite dhe interpretimeve të ndryshme, përmbaruesit mos të bëjnë shkelje,pa fajin e tyre,por për shkak të dispozitës së sqaruar.

Pas seancës dëgjimore, dëgjimit të palëve, Komisioni Disiplinor me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar se në këtë rast Përmbaruesi Privat, nuk është përgjegjës për asnjërin nga shkeljet disiplinore të përcaktuara me nenin 367 të LPP-së, Këtë konstatim komisioni e bazon në dokumentin përmbarimor, kontratën e pengut dhe shkresat tjera të lëndës.

Sa i përket pretendimeve të palës ankuese lidhur me karakterin suspenziv të prapësimit, komisioni për këtë pjesë i është referuar dispozitave ligjore, konkretisht nenit 47, pika 7 të LPP-së dhe dispozitave lidhur me ekzekutimin gjyqësor të pengut, ku me nenin 167 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore pika e parë ceket se "Pëngmarrësi i pengut pa posedim mund të paraqesë një kërkesë në gjykatën kompetente, që pa pjesëmarrjen dhe dëgjimin e pengdhënësit apo personave të tjerë, atë t'a autorizojë që sendin e lënë peng, t'a sekuestrojë dhe t'ia dorëzojë pëngmarrësit. Rreth kësaj kërkesë, gjykata duhet të vendosë më së voni pesë (5) ditë pune pas datës së paraqitjes së kërkesës".

Në pikën e dytë të këtij neni ceket se "Pengdhënësi ose debitori i kërkesës së siguruar, nëse ky nuk është njëkohësisht pengdhënës, mund të paraqesë kërkesë në gjykatën kompetente që të konstatohet se, e drejta e pengut është e pavlefshme tërësisht apo pjesërisht. Nëse gjykata vendos një konstatim të tillë, ajo duhet njëkohësisht të vendosë a do t'a abrogojë apo do t'a ndryshojë vendimin e nxjerrë në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, dhe nëse vendos kësisoj, duhet të vendosë nëse pëngmarrësi përgjigjet dhe në cilën shumë përgjigjet për dëmin që është shkaktuar përmes vendimit për sekuestrimin apo dorëzimin e sendit të lënë peng tek pëngmarrësi.

Kjo pjesë është e rregulluar me Ligj të Veçantë dhe pala debitore, referuar nenit të njejtë, pika e dytë, do të mundet që të vërtetojë një gjë të tillë dhe të kërkojë edhe kompensimin e dëmit të shkaktuar nga organi përmbarimor, nëse do konstatohet se kërkesa e palës për ekzekutim të pengut në posedim, është e pavlefshme. Pasi komisioni nuk ka pasur ndonjë provë të tillë sikurse parashihet në pikën 2 të nenit 167 të LPDTS-së e ka pasur të pamundur që të vlerësojë lidhur me faktin se a është ekzekutuar pengi konform dispozitave për ekzekutim gjyqësor të pengut e duke pasur parasysh edhe deklaratimet e organit përmbarues se veprimet kanë ardhur duke u interpretuar kësisoj, pa qëllim të krijimit të ndonjë dëmi apo shkelje si dhe kërkesa që mos të veprohet në të ardhmen pa pasur një sqarim dhe interpretim të kësaj dispozite nga organet kompetente.

Komisioni ka trajtuar edhe si provë vendimin e gjykatës, me të cilin është aprovuar ankesa e palës debitore për parregullsinë e përmbaruesit, por i njejtë vendim, nuk është i plotfuqishëm dhe është në diskrecion të gjykatave të vendos sipas çmuarjes së tyre për vendimet e tyre, ndërsa komisioni i trajton rastet, si komision i pavaruar dhe duke u bazuar në provat dhe deklaratimet e palëve. Mbi bazën e të dhënave si më lart, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT

DPL.nr.25/2022 datë 23.09.2022

Kryesuesja e Komisionit Disiplinor

Manushe Karaçi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.

